VENDIM
Nr. 14, datë 7.2.2018

PËR NJË NDRYSHIM NË RREGULLOREN "PËR ADMINISTRIMIN E RREZIKUT TË LIKUIDITETIT"

Në bazë dhe për zbatim të nenit 3, pika 3, nenit 12, shkronja "a" dhe nenit 43, shkronja "c", të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, "Për Bankën e Shqipërisë', të ndryshuar; të nenit 26, pika 1, shkronja "a" dhe nenit 66, të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006, "Për bankat në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, me propozimin e Departamentit të Stabilitetit Financiar dhe të Departamentit të Mbikëqyrjes,

VENDOSI:

1. Në rregulloren "Për administrimin e rrezikut të likuiditetit", miratuar me vendimin nr. 71, datë 14.10.2009, të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, e ndryshuar, të bëhet ndryshimi i mëposhtëm:

a) Në nenin 19, pika 3, shkronja "a" ndryshon me përmbajtjen e mëposhtme:

"në monedhën kombëtare (lekë) në nivelin minimal 15% (pesëmbëdhjetë për qind) dhe në monedhë të huaj në nivelin minimal 20% (njëzet për qind); dhe"

2. Bankat të marrin masat për plotësimin e kërkesave të pikës 1 të këtij vendimi, brenda datës 31 mars 2018.

3. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes së Bankës së Shqipërisë për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

4. Ngarkohet Kabineti i Guvernatorit dhe Departamenti i Kërkimeve me publikimin e këtij vendimi, përkatësisht në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë dhe në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Gent Sejko